

Zeqije XHAFÇE¹

PËRDORIMI I TURQIZMAVE NË REGJISTRA TË NIVELIT TË ULËT TË FORMALITETIT

Abstrakt

Hulumtimi ynë trajton një pjesë të rëndësishme të leksikut shqip, i cili ka qenë objekt i studimeve të shumta të gjuhëve të Ballkanit. Thënë ndryshe, ky hulumtim ka për qëllim të nxjerrë në pah funksionet e kësaj pjese të leksikonit shqip të njohur si turqizma, në tekstet e nivelit të ulët të formalitetit. Analiza e përdorimit të kësaj pjese të leksikut shqip është realizuar në bazë të teorisë së gjuhësisë së korpusit, teorisë së gjuhëve në kontakt dhe qasjes sociolinguistike ndaj regjistrave të gjuhës. Studimi mbështetet në shumëfunktionalitetin dhe pluralizmin gjuhësor, në bazë të të cilit është hulumtuar funksionalizimi i turqizmave. Studimi është realizuar në kërkim të përgjigjes në pyetjet: A janë zhvendosur turqizmat nga regjistrat e nivelit të lartë të formalitetit në nivelin e ulët? Për ta gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje janë trajtuar turqizmat e tre korpuseve të regjistrave të shqipes së folur dhe të shkruar.

***Fjalë kyçe:** turqizmat, leksiku shqip, gjuhësia e korpusit*

¹ Lektore e Gjuhës Turke në Departamentin e Orientalistikës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.

Hyrje

Sipas qasjes multifunksionale gjuhësore një “fjalë” pranë funksionit të shquarjes së përmbajtjes dhe formës së saj mund të ketë edhe funksione të ndryshme, dhe si e tillë ajo shquan një stil dhe një regjistër. Në këtë studim do të përpiqemi ta identifikojmë statusin dhe funksionet e turqizmeve në leksikon e gjuhës shqipe, të cilat janë edhe objekt i studimit tonë. Qëllimi i këtij studimi është që me një qasje të tillë të theksohet rëndësia dhe pazëvendësueshmëria e turqizmeve me fjalë të tjera.

Turqizmat kanë qenë edhe më parë objekt i studimeve të shumta të studiuesve vendorë dhe të regjionit, sidomos në kontekstin e gjuhëve në kontakt (Reinkowski 2012, Kazazis 1965, Krajni 1965, Mulaku 1977, Desnickaya 1963, Kostallari, 1978, Mehdiu etj.). Shqyrtimi i studimeve na tregon se konstatimet lidhur me funksionalitetin e turqizmeve janë bërë me fokus të veçantë në gjuhën standarde dhe letrare. Pra, kur thuhet se ato janë mjete të mira stilistikore, si varietet hulumtohen vetëm stilet letrare. Ajo që u mungon studimeve të sotme është hulumtimi i përdorimit të turqizmeve në regjistra të ndryshme të shqip-folësit. Një studim i tillë do të tregojë varietete të ndryshme varësisht nga qëllimi, situata, konteksti dhe shumë kriteret e përkufizimit të regjistrit dhe stilit. Thënë shkurt, ato nuk janë studiuar si një zgjedhje gjuhësore e detyrueshme ose e lirë; në regjistra ku ato mund të përçojnë mesazhe të ndryshme varësisht nga qëllimi i komunikimit dhe i kontekstit.

Analiza e përdorimit të kësaj pjese të leksikut shqip është realizuar në bazë të teorisë së gjuhësisë së korpusit, teorisë së gjuhëve në kontakt dhe qasjes sociolinguistike ndaj regjistrave të gjuhës. Studimi mbështetet në pluralizmin gjuhësor, në bazë të të cilit është hulumtuar funksionalizimi i turqizmeve. Ky studim është realizuar në kërkim të përgjigjes në pyetjet: A janë zhvendosur turqizmat nga regjistrat e ni-

velit të lartë të formalitetit në nivelin e ulët? Për ta gjetur përgjigjen e kësaj pyetje janë trajtuar turqizmat e 3 korpuseve. Korpusi i parë përbëhet nga bisedat joformale të 30 shqipfolësve. Korpusi i dytë përbëhet nga tekstet e këngëve popullore, rap dhe hip-hop, si zhanri i nivelit të ulët të formalitetit. Korpusi i tretë përbëhet nga tekstet e titujve të gazetave dhe reportazhave të personave politike, në rrjetet sociale dhe platform të tjera. Këto të fundit edhe pse të shkruara në variantin e shqipes standard, manifestojnë nivel më të ulët të formalitetit.

1. Sfondi teorik


Studimi i përdorimit të turqizrave mbështetet në heterogjenitetin e gjuhës. Koncepti i varieteteve është trajtuar së bashku me konceptet e tjera, siç janë: njësitë gjuhësore dhe bashkësitë gjuhësore në studimet sociolinguistike. Varietetet gjuhësore janë qasur në kuadër të teorive të ndryshme. Duke u nisur nga konstatimet se gjuha nuk është bllok monolit, Shkurtaj e definon gjuhën si “tërësi e varieteteve gjuhësore në të cilat ajo na shfaqet” (Ismajli, 2019:57). Varietetet përfshijnë aspekte të ndryshme të gjuhës. Ato mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Në studimet sociolinguistike shpeshherë flitet për varietetet të nivelit të lartë të përgjithësisimit, siç janë: dialekti gjeografik ose social. Dialekti gjeografik përbëhet nga një bashkësi folëse që jeton në një vend dhe ka karakteristika të përbashkëta gjuhësore, ndërsa sociolekti përbëhet nga varietetet të folësve që i përkasin grupit demografik të përbashkët.

Studimi ynë do të merret me varietetet funksionale, siç janë: regjistra, zhanre, stile të cilat sipas përkufizimit nuk janë konvencionale si dialektet. Rugova & Sejdiu-Rugova (2015:76), po ashtu, na përkujtojnë se në gjuhësinë shqiptare janë shfrytëzuar stilet funksionale, siç janë: stili shkencor, stili zyrtar, stili publicistik, gazetaresk dhe stili i letërsisë artistike. Lloshi, në pjesën e stilistikës funksionale, për të cilën thotë se përdoret edhe termi regjistër, përmend edhe stilin e

veprimtarisë shoqërore politike, fetare, shkencore e teknike (Lloshi, 1999:157). Që do të thotë se perspektiva e zhanrit, regjistrit dhe stilit shpesh janë përdorur si të njëjta.

Rugova & Sejdiu-Rugova, si Halliday-i, këto dy kategori i përkufizojnë në mënyrë më precize, duke e vendosur në qendër kriterin e zgjedhjeve gjuhësore dhe funksioneve të tyre. Sipas tyre, “Stili është zgjedhje e lirë ndërmjet njësive të gjuhës që e japin përafërsisht të njëjtën përmbajtje, por që ndryshojnë nga struktura dhe/ose funksioni gjuhësor, duke krijuar shprehje dalluese gjuhësore. Ato rëndom përfshijnë nocione si zgjedhje gjuhësore dhe nuk mund të përkufizohen në mënyrë absolute. Stili si varianti i papërkufizueshëm klasifikohet varësisht nga orientimi” (Rugova & Rugova, 2015:76). Ndarjen e stileve e mbeshtesin në ndarjen e Werlich-ut, i cili e bazon në dy kriteret kryesore:

1. Sipas nivelit të formalitetit
2. Sipas funksioneve të gjuhës



Skema 2: Ndarja e stileve sipas Rugova & Sejdiu-Rugova (2015)

Duke pasur parasysh se varieteti mund t'i jetë nënshtruar "normës", për shkak se zgjedhja mund të ndahet në variante të lira dhe variante të detyrueshme, autorët cekin se një zgjedhje mund të jetë e varur nga rrethanat e ndryshme gjuhësore dhe të përcaktohet nga një kategori teksti a ndonjë funksion i caktuar komunikimi që përbën domen komunikimi më vete. Si të detyrueshme këto zgjedhje gjuhësore përbëjnë një kategori tjetër të quajtur regjistër (Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015:76). Autorët e pranojnë ndarjen e Werlich-ut edhe për regjistrat, me dallimin që, te to, zgjedhja përcaktohet nga shkalla e formalitetit dhe domeni i përdorimit.

Përveç kësaj, Leech (1981), në veprën "Style in Fiction" përmend tri qasje akademike ndaj stileve gjuhësore: monoiste, dualiste dhe pluraliste. Përderisa, dualisti mendon se ekzistojnë mënyra të ndryshme për përcuarjen e kuptimit, monisti është i mendimit se ky është një mendim i gabuar, sepse çdo ndryshim i formës sjell një kuptim të ri. Sipas pluralistëve gjuha performon një numër funksionesh të ndryshme dhe çdo pjesë e saj është rezultat i përzgjedhjeve të bëra në nivele të ndryshme funksionale. Prandaj, pluralisti nuk është i kënaqur me ndarjen dualiste midis "shprehjes" dhe "përmbajtjes", kuptimet dallojnë sipas funksioneve dhe gjuha është thelbësisht shumëfunksionale. Çdo shprehje e mendimit (me fjalë, fjali, togfjalësh etj.), qoftë edhe më e thjeshta, përçon më shumë se një lloj të kuptimit. Prandaj, Leech (1981), mendon se supozimi se gjuha shërben për t'i komunikuar mendimet dhe idetë është shumë e thjeshtësuar. Variantet e ndryshme gjuhësore kanë funksione të ndryshme, siç janë funksionet referuese (artikujt e gazetave), funksioni drejtues ose nxitës (reklammat), funksionet emocionuese ose sociale (bisedat e rastësishme) (Leech, 1981:24). Secili funksion i korrespondon një aspekti thelbësor të një situate të diskutit.

Turqizmat janë një pjesë e veçantë e leksikonit të gjuhës shqipe, e cila i ka interesuar studiuesit sidomos në kontekstin e spastrimit të gjuhës. Gjatë formimit të variantit standard të gjuhës shqipe janë bërë

përpyjekjet për t'i përjashtuar ato nga fjalori dhe janë përdorur gjithmonë e më pak në variantin e folur e të shkruar të gjuhës standarde. Studiuesit janë të mendimit se numri i turqizmeve po zvogëlohet dhe ato përdoren si mjete stilistike në gjuhën letrare. Po ashtu, janë të mendimit se ato ende do të jenë prezente në gjuhën popullore (Reinkowski, 2012; Kazazis, 1969). Duke u nisur nga këto konstatime, si dhe nga studimet sociolinguistike të varieteteve të një gjuhe supozojmë se turqizmat do të shfaqen si zgjedhje gjuhësore të detyrueshme, si dhe të lira në varietetet e gjuhës së shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe. Si zgjedhje të detyrueshme mund të trajtohen të gjitha turqizmat tashmë të regjistruara në leksikografinë e gjuhës shqipe, ngase ato janë tashmë të pranuar dhe të regjistruar. Mirëpo, jemi të mendimit se një numër i konsiderueshëm i turqizmeve është zhvendosur në regjistrat e nivelit të ulët të formalitetit të gjuhës shqipe; si dhe se turqizmat janë zgjedhje gjuhësore funksionale jo vetëm në gjuhën e teksteve letrare, por edhe në gjuhën e folur. Andaj, kemi e bërë analizën e varietetit të gjuhës së folur shqipe, ku folësit flasin në nivel të ulët të formalitetit, ngase janë intervistuar nga fëmijët e tyre; si dhe varietetin e gjuhës së shkruar të vëzhguar në bazë të teksteve të dy regjistrave të ndryshme të nivelit të ulët të formalitetit.

2. Turqizmat e korpusit të përbërë nga tekstet e intervistave

Ky korpus përbëhet nga 32 folës të intervistuar nga ana e studentëve të Degës së Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filologjisë - Universitetit i Prishtinës. Të intervistuarit janë në marrëdhënie farefisnore me intervistuesit; zhvillohen në ambientin shtëpiak; temat e bisedave kanë të bëjnë me rrëfimet nga jeta e tyre, rinia etj. Kështu që bisedat zhvillohen në një nivel të ulët (intim) të formalitetit. Sa i përket të dhënave socio-demografike të intervistuarve mund të themi se shumica janë afër dhe mbi moshën 70 vjeçare. 30% e të intervistuarve nuk janë

deklaruar për moshën e tyre ose janë nën moshën 70 vjeçare. Pjesa dërmuese e të intervistuarve jetojnë në pjesët rurale të Kosovës dhe disa prej tyre janë nga qytetet, si: Istogu dhe Rrahoveci. Statusi arsimor i tyre është shkolla fillore 4 vjeçare. 53% e të intervistuarve janë të gjinisë femërore. Korpusi përfaqëson pjesën e folësve të moshuar, me arsim minimal dhe të folurit të pjesëve rurale.

Rezultatet: 13 prej të intervistuarve përdorin mbi 20, ndërsa 11 të intervistuarit përdorin më pak se 20 turqizma gjatë intervistës. Numri mesatar i përdorimit të turqizmave për person është 16.93.

Numri total i turqizmave të përdorura në korpus është 252, 74 prej të cilave përsëriten te më shumë se një folës. Karakteristike për këtë korpus është dominimi i përdorimit të turqizmave në domenin fetar dhe shtëpiak. Si dhe variantet e ndryshme fonetike të fjalëve që ndryshojnë sipas individit/idioketit. Dendësia e përdorimit të turqizmave është shumë më e lartë sesa te të intervistuarit të korpusit HGK . Kjo është evidentuar edhe gjatë krahasimit të kohëzgjatjes e intervistës së individit, e cila ndryshon midis 4-20 min. Nga ana tjetër, kohëzgjatja e intervistës së një individi të HGK-së zgjat mesatarisht midis 1h-9h. Përjashtim bëjnë 11 të intervistuar të cilët kanë folur midis 5-10 min. dhe shfaqin përdorim minimal të turqizmave. Tre të intervistuar kanë zhvilluar biseda 35 minutore dhe gjatë kësaj kohe kanë përdorur nga 12-17 turqizma. Këta të fundit i përshtaten profilit sociolinguistik të të intervistuarve të këtij korpusi. Të dhënat socio-demografike të të intervistuarve dhe intervistave të këtij korpusi janë dhënë në shtojcën e inkuadruar në Grafikonin 1, i cili gjendet në fund të punimit.

Turqizmat e regjistruara nuk përdoren për qëllime të veçanta me ndonjë qëllim të caktuar ose në funksionin shprehës me stilin ironik, hiperbolik apo metaforik, megjithatë u përkasin domeneve të ndryshme të përdorimit, siç është domeni i religjionit, kulturës popullore. Kjo evokon praninë e bashkëbiseduesve që i përkasin fesë së njëjtë. Turqizmat e përdorura janë zgjedhjet gjuhësore stilistikisht të natyralizuara. Numri i turqizmave të domenit fetar është shumë më i lartë nga korpu-

si HGK. Shumica e këtyre fjalëve nuk janë regjistruar në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1981). P.sh.: emërtimet e lutjeve fetare, siç janë: kylluvallai, supaneke.

Prej një individi te tjetri hasen në forma të ndryshme fonetike të turqizmeve me kuptim të njëjtë, p.sh.: bëllok-bolluk-bollik.

Turqizmat e regjistruara në këtë korpus janë:

adet, aknagjish, aksham, allaekber, allah-alla, allah, allbuçi, ana, aradhat, argat, ater, avdes, avli, axhallarë, axhë, baballart, babë, babxhyshi, badihava, bahçe, bajagi (bejgi), bajram, bakllava, barabar, barbarta, bardak, barem, bash, bashllëk, bashqe, batall, begenisen, bëllok (bolluk, bollik), boll, bollicë, berber, bereqet, bezbeli, bile, bismila, budall, bunar, çaj, çare, çebe (qebe), çef (qef), çehre, taman (tamon), çerep, çeshit, çoban, çorbatanalla, çylym, daja, demek, demelicë, dert, dimia, dinar, dov, duganja, durak, dynja, elham, farz, fistana, fitilaqi, fukarallëk, gajle, gazep, gjenar, gostërma?, gurabia, gurbet, hajt, hala, halitshëm, hall(all), hallakat, hallk, harxhime, harxhove, hasçuka, hasret (hastret), haxhi, hazer (hazdër), hidare, hiq (hiç), hoxha, hudba, hujdisme, hyzmet, ibret (shëmtuar), içindija, imbër, inat, top, ingja, ishalla, jacija, jarebi, jasin, jastëk, jelek, jëlla, jemek, jetima, jolla/jalla/jo valla, jorgan, kabigjikat, kabull, kaca, kaceme, kafaz, kafe, kaftjalli, kallabllak (kallaballok), kallamoç, kapuçë, kasaphone, kasarna?, kazan, keishi, kërneze, kijamet, klluq, kof (kova), kojshi, kojshike, kollaj, kollqin, koxha, kulaç, kumash, kunrat (kundra), kusur, kylluvallai, kysmet, laf, lezeti, llampë, mahall, mandolin, maxhë?, mazalla, merak (marak), misër, mishteri, muhabet, muhasebe, musaf, mysliman, mysafir (musafir, misafir), myshteri, nejse, njet, oçkurri, oda, ogjak, paça, papuqe, paqare, pare, pazar, pite, qeiz (qez), qeman, qerapa, qille, qitili, qivija, qosheve, qulin, qylin, qylym, rahat, rahatnam, rahatojshin, rahatume, parahatune, rahmet, rahmet shpirti, raki, reçat, regat, sabah (saba, saba (namaz)), sabahi namaz, sabajle, sabri, saç, sahat, sahih, samar, sarmë, sefa, sefte, selam alajkum ve rahmetullah, selamet, selavati vitër, sëllte,

sevda, sexhd, shamija, sheh, sherbet, shiqer, shyhret, shyqyr, subhaneke, subhanerabbelazim, supaneke, qylym, synet (sinet), sinetllëk, tahmin, takat, tarife, tavan, tebare, tehjat, telashe, temeli, tentene, tenxhere, tepsia, teqja, tezja, tirbe, turli, tybe, tybe, vaki, valla billahi, vallahi (valla), vatan, vezare, xhade, xhadhet, xhaja (guya), xhami, xhandarmerija, xhirdek, xhuma, xhynah, yrnek, zahre, zanat, zara, zarar, zejtin, zinxhir, zor, zorshme, jalla jarebi!

3. Analiza e turqizrave në tekstet e këngëve të muzikës shqiptare

Regjistra të nivelit të ulët të përgjithësimin konsiderohen regjistrat, të cilët vëllimisht janë tekste të shkurtra që nuk kanë përmbajtje të gjera (Biber, 1994:34). Zakonisht përdoren për të përçuar ndonjë mesazh, emocion apo për qëllime të tjera, për të arritur një efekt të caktuar te masat më të gjera të audiencës ose të lexuesve. Titujt e gazetave, abstraktet e punimeve shkencore, postimet e shkurta në rrjetet shoqërore etj. janë vetëm disa nga ky lloj i regjistrave. Në këtë lloj të regjistrave huazimet janë ndër zgjedhjet gjuhësore të shpeshta që mund të dëgjohen. Për këtë studim kemi bërë analizën e këngëve të muzikës pop, rep, hip-hop dhe këngëve popullore, si dhe postimeve të personave publikë dhe jopublikë, të titujve të reklamave dhe të gazetave, për ta vëzhguar prezencën e turqizrave dhe funksionin e tyre.

Qasja e përgjithshme ndaj fjalëve mund të veprojë si reflektim i shumë dimensioneve të zhanrit dhe diskursit (Biber & Finegan 1991). Pikëpamja multifunktionale gjuhësore na tregoi se fjalët, pranë funksionit të sinjalizimit të përmbajtjes dhe formës, mund të kenë funksione të ndryshme për të sinjalizuar një stil dhe regjistër. Steen (2002), gjatë analizës së këngës “Hurricane” të këngëtarit të famshëm Bob Dylan-it, thotë se: “Këngët vazhdimisht po iu ofrohen një segmenti relativisht të madh publik të komunitetit të diskursit. Prandaj, shumica e këngëve janë realtivisht të njohura mirë nga ana e publikut. Ajo, që është më e

rëndësishme për ne, është fakti se edhe fjalët e këtyre këngëve janë relativisht të njohura. Ato imponohen më shumë sesa fjalët e një tipi tjetër të diskursit. Duke e marrë parasysh funksionin e përgjithshëm të muzikës pop, pra argëtimin e njerëzve, dëgjuesit kanë shkuar aq larg, saqë kanë filluar t'u bëjnë këngëve edhe analiza. Kjo do të thotë se ekziston një nivel relativisht i lartë i vetëdijësimit gjuhësor në produksionin dhe konsumimin e muzikës pop” (Steen, 2002:188). Sipas tij, të folurit dhe këndimi janë dy medime të ndryshme të të shprehurit. Këngëtari shpesh shfrytëzon nivele të ndryshme të informimit, për të arritur një përshtypje të dëgjuesi. Aspektet specifike muzikore të këndimit, melodija dhe ritmi janë një nivel tjetër i informacionit. Këto medime janë lidhur me dimensionin e zhanrit të tekstit. Një dimension tjetër është forma apo roli i gjuhës dhe metaforës. Nga analizat e bëra, Steen konkludon se në formën e një varieteti pak a shumë të njohur gjuhësor, gjuha vetë është fjalë e një skeme të zhanrit (Steen, 2002:183-192). Për të kuptuar se a janë turqizma elemente gjuhësore të përdorura nga autorët e këngëve, kemi bërë analizën e teksteve të muzikës popullore të vjetër dhe të kohëve të fundit. Siç kemi përmendur edhe më parë (3.3.6.), tekstet e këngëve të vjetra popullore tashmë janë trajtuar nga shumë studiues (Çabej, Koliqi, Kaleshi etj.). Qëllimi i kësaj analize nuk ishte përsëritja e asaj që është thënë, por krahasimi i leksikut të këngës bashkëkohore popullore me atë të vjetrin.

Janë analizuar 15 këngë të zhanrit të muzikës popullore dhe këngë të dasmave, ku turqizmat dalin në përshkrimin e veçorive fizike të femrës, në përshkrimin e atmosferës, të dashuruarit dhe të dashurisë. Po ashtu, ka edhe këngë patriotike, ku na dalin turqizma të vjetëruara ose krahinore: at (kali), kërbaç etj. Ato reflektojnë kulturën orientale të popullit shqiptar. Si nga instrumentet e përdorura, ashtu edhe nga teksti shihet se të gjitha elementet janë në stilin evokues. Evokojnë një ambient, një frymë, kulturë orientale. Ja disa shembuj:

- (1) leje jetën e marrë me zor sun e majm
lidhja jonë s'pat zarë n'jetën teme mo nuk je ti mo nuk je
Hajredin pasha ku e ke lanë atin,
ne Dibër t' Madhe e kam lanë t' ngratin (Këngë popullore)
- (2) Po knojna me def (4x)
ishalla perhajn e me muhabet (2x)
hajde me shuplak (4x)
ishallaa perhajn edhe me nafak(2x)
- (3) Sa e bukur na ka dalë nusja, marshalla, marshalla!
E bukur për bukuri-e
Paska shtatin o si selvi-e
Paska ballin o perishan-e
Paska vetllën o si gajtan-e
Paska synin-o si filxhan-e
Paska hunden-o miskavi-e
Paska faqet-o gurabi-e
Paska gojën-o si kuti-e
Paska dhamët-o si inxhi-e
Ma gëzofsh-o dhandri i ri-e

Prezenca e kulturës orientale te 10 këngë popullore të viteve të 2000. Përmbajtja e këngëve reflekton stilin e jetës dhe traditat e një familje myslimane shqiptare. Turqizmat këtu luajnë rol të rëndësishëm në të shprehurit e asaj atmosfere, ngase ato janë huazime kulturore, të cilat do të jenë të pranishme në gjuhën e këngës popullore të kultivuar nga populli. Shembulli më i mirë janë ato fenomene shoqërore, si: “me qenë beqare”, “me bo hysmet”, “me bo gjymysh”, të cilat me vete sjellin konotacione specifike.

- (1) Ti moj nanë mos u mërzit
Jam beqare dhe naj ditë
Shpejt vjen koha me u martu
Boll oj nanë kam me punu.
- (2) Nime jena kallablak
e kem jetën për marak
Ku jem na e bajm shyhretë
për vëllazni e kallim krejt
- (3) Për ditëlindjen tande krejt shoqinë unë ta ka m' thirrë
Çare ska pa u bo mirë
T' dihmojna me ba hysmet (oh me ba hysmet)
Nuk t'i lajna punët krejt (oh ty punët krejt)
- (4) Se naj bone zemrat mal
Bashk me nusen bon gjymysh
Inshaallah s'ju marrin msysh
- (5) Je e vetmja n'ketë dynja
dy si ti kërkush s'i ka
Eshtë veshtirë hallkut më t'dal
In sha Allah naj bën hallal
- (6) Nuk po kam nafak me t'pa
e po ndjej shumë mall
Ra llafi për ty
U mundova boll me u rujt
Po çerja me kish lujt
Mos e pij pa mu, e tu baftë pelim
Ku po rrin ti, ku po rrin
ska udhëtim ma t'mirë n'dynja
se kur nisem ty me t'pa
mos me m'pa, ti mos me m'pa
rahat gjumin ski me ba

Përveç këtij zhanri të muzikës, janë analizuar 46 këngë të disa këngëtarëve të muzikës pop, rap dhe hip-hop. Ja disa shembuj, ku turqizmat tregojnë përdorime të motivuara nga faktorë të ndryshëm.

- (1) Bota u ndryshu krejt njerëzit pesh jun çu dita kijametit tu na afri
S'kam un për veti ik se më myti mu sikleti
Çohuni pi gjumit harroni, rrugët e kqija kini mi ra pishmani kur ju ze pleqnia
Nuk i shkon mendja te fukaraja paraja të bon për veti e ka harru Zotin i shkreti u prish kejt mileti (Balaj)
- (2) Ashiçare s'o inati por s'o ka më pëlçen (Balaj)
- (3) It's all love though sonte si dihet,
Jena shum plot kallabllak, ambienti me dritat e ulme n'max
Ha ha veç për inati, kundra ligjit kundra djallit (Noizy)
- (4) Mos u alarmoni money, se alarmi s'boni 200-inshet të verdha kallabllak i thirri minioni
.. Mjeshtri i lojnave fjalës dajrexhit ja thojna dajres vi prej anës ku ja feelin njoni tjetrit gajlen/Djemtë e lagjës kur bojn pare mu kejt zemra m'knaçet/Kanaqet plot ilaçi dosti moti n paqe/ Me t'mahallës bashkë like Wu Tang Staten Island/.../Ama shpatën kur secili ka gjynahe/Loqka menemadhe lahet n t'amel vaska e madhe/.../Kujtimet plaken ski ushqim as me shtru darken/qato njerzve su ha raki n'dy sahati e thejn bankën/..tash marr pare Edhe t'hënë tu bo hustle për idare (Mc Kresha)
- (5) Banesa jem o green house en Prishtin/Jeshile nTiran e verdhë nArgjentin/..E kthej në Prizren/Çok zor e kalushme/E vetdashunume/Zemrën vetës Sja thej/.../Asni llaf sma shkrun mu ghosti mfal/... (Tayna)
- (6) Du mu kthy te shpija/e di që dada Vere/Apet ka me qit flija/Kshtu që bire do raki/Kujdes me Allti/Thirri Zhutat n'so-

- fës/Le ta kallin çifteli/çaty pak ma nalt/Pushon trupi i gjyshit
tem/M'ka marr malli për kët sen/Sa mir me kan n'dhe tem
Dost (Shqiptar-Unikkatil)
- (7) Thirrna hip hop i ri po vim pi blokut back/Pasha flow-in e boj
më mirë se ky milet/.../Rima lidh si kollat, ... rollitet n'dollar
Unë jam rapsodi n'rep t'sodit/Ngo ti haverit, Money I get
it.../Veshun mas freshi, Edhe veq cash vjeli/reperi më i serti,
e di që t'nijn vesht njeri (MC Kresha)
- (8) Krugës së përditshme, paret n'zarf, njerzit dojn mem hjek
mu/man I call it blof/Nike Air Max/Tu u ni si ESNAF/Got so
much white/Ja kom nis e po rrshas/Fjalt i maj n'raft/Kur vin
dajt s'boj laff/.../Ky virani o sick Zonin radiofonik/Kur jom
astronomik/Seattle supersonic (Mc kresha feat Lyricsl Son)
- (9) Shokt jan nis për pun/Pa bo zhurëm/S'kan lon gjurm/Sa her
që dalin n'tour/E kapin lek, dukat, e gure/Aty-Ktu/Naj piktu-
rë/Që shitet shtrejt nëpër dure/Prej tregut zi tu dal i bardhë si
bilure (Mc Kresha&Singular)
- (10) Kta që ngecin mbrapa m'fal po smunem me ju kulturu/Sa mir
që s'jena shok e s'kena nevoj me ju nimu/Aleksandër Gjok/
tu vujt për Juve kuturu (Lyrical Son)
- (11) Ngom mu tezak/3-2 vjet Hala fresh si 20/Rab-in fresh tu
pikyqje lezet/Pushka nër dyshek e musht plot fishek/Jo u
qyqe po çu kce çyçek/.../ Tu bo hustle ton ditën/Unë hazër
jom npritje
- (12) I madhi zot e din
Sa m'ka marrë malli
Oh veç niher me t'pa breh
Kta sy ti çmalli
Për çdo namaz breh babë
Po boj dua me u taku
N'xhennet e kurrë mos me u nda (Gold Ag)

- (13) Dikuj i doket shum jeta, e dikujna pak,
Pate s'pate pare, dije deken e ki hak.(AG Gold)
Kosoven na mloj kejt rrena e hajnija
Hajnat po na majn se vet ja kem bo venin
Bojn hajgare qeverija parlamenti ministrija
Veq tuten pi neve tybe na lojn pa XHAMIJA
Ju muni me kallxu veq qysh vidhet vatani
Kejt i kan n'dyzen tash po i pengon EZANI
Ma ofendon ISLAMIN e ma ofendon SHAMIN
...
Kejt ju hajduka qe miljonat pi paloni
Se tjetër bot s'besoni se keq ju mashtron dynjaja
Ju mashtroj rakija k* e sefaja
Fajdexhi u mush ky vend kamos n'diten e sodit
...
Hatri jon ëe lutmi e frik t'kina veç ty
Udhzot kta qafira qe nuk din tut prej teje
Mos e mer fejne prej njeri po msoje prej KURANI
Kosova osht e jonja der sat ka pluma alltija
E anej ka veni jem dibiduzat bojn hajgare (Shqiptar-Gold Ag)
- (14) Ke menu që dashnia o veç pare
Ke menu që dashnia o hajgare
Punt i kom n'terezi
Po vet s'jom n'terezi
Kjo mani fantazi (tayna)
- (15) Ta jepa dashnin
E ti se ktheve e le seen
Ishalla pom nin nin
Ishalla pom nin

- Per qefin e tonve(tonve) (ja ja
Tkom pas pik tdoht (gjesti -idiote)
- (16) Xhinja çojn hate,
E di që kërkon nuk e dojn
Qysh e shoh t`ardhmen a?
Vllai, vallai boll zor,
Masi krejt greddy per
Lek, followesa fame
edhe televizor.. (Ledri Vula-Piano rap)
- (17) A e di me kon po fol are you dumb vlla
Pyti koleget me mu t'bjen damlla, damlla (Noizy)
- (18) Kjo o jeta nëpër rrugë që veç filma e ke pa,
Zotit ja kom borxh do gjynahe për mi la,
E di që kena hustle, po për ta jena hazer
Ja rabi buka n'fyt i mbet
Qaj qe thote Gjiko nuk o i ver, shqipe (Gjiko-Çunat e rrugës)
- (19) Qaj bajraktari
O qaj mafia
Qe krejt i kalli
Hajde luj çyçek
Mori shyhret
E kale krejt
Sa paska lezet (Ylli Demaj & Yllka Kuqi)
- (20) leje jetën e marrë
me zor sun e majm
lidhja jone s'pat zarë
n'jetën teme mo nuk je
ti mo nuk je (Elvana Gjata)

Siç mund të shohim edhe nga shembujt e lartshënuar turqizmat janë prezente gati në të gjitha zhanret e analizuara. Në zhanrin e muzikës rep dhe hip-hop, përdorimi i tyre tregon një rritje. Prezenca e tyre mund të lidhet për dy arsye: 1. për shkak të formës gjuhësore, rimës dhe ritmit; dhe 2. për shkak të qëllimit të kontekstit të trajtuar dhe motivimit e autorit. Motivimi manifestohet në rrafshin emocional (hidhërim, zemërim, gëzim), qëllimi i komunikimit me dëgjuesin, dhe temë (feja). Në disa tekste të këngëve të G. A. me prejardhje nga Presheva, të cilat vlerësohen si këngë religjioze dhe patriotike regjistrohen më shumë turqizma të përdorura në stilin evokues, bindës dhe ironik. Janë analizuar 10 këngë të të njëjtit autor, për ta krahasuar përdorimin e turqizmave sipas temave të trajtuara. Njëra prej këngëve del me një numër të lartë turqizmesh, te të tjerat nuk shihet një intensitet shumë i lartë. Kënga në fjalë shpreh revoltën e autorit ndaj qeverisë, mburjen me identitetin e vet si përkatës i fesë islame. Në njërin prej teksteve të këngëve të tij regjistrohet një turqizëm i ri, i cili nuk zë vend në leksikografinë e përdorur për këtë studim. Ajo fjalë është “iftijaç” (tur. ihtiyaç) e cila e ka kuptimin e fjalës shqipe “nevojtar”. Në FFHGJSH regjistrohet fjala me kuptim të njëjtë, por në paradigmën arabe “myftijaç”. Natyrisht se kjo tregon që në të folmet e ndryshme të gjuhës shqipe ende ekzistojnë turqizma apo forma të ndryshme të turqizmave të paregjistruara.

Punojm dit e nat për ni grim e ni tro

Veç sa tjena gjall iftijaç kurr mos mu bo

Përdorimi i shprehjeve frazeologjike, po ashtu, nuk mungon. Turqizmat e përdorura në këto njësi leksikore shumëfjalshe tregon se turqizmat janë pjesë e njërive leksikore të gjuhës shqipe, të cilat kanë një stabilitet semantik dhe sintaktik, dhe si të tilla kanë funksion metaforik, theksues dhe intensifikues (14).

4. Analiza e turqizimave të teksteve të shkurtra

Janë trajtuar edhe postimet në rrjetin social *Twitter* të 10 personave publikë, si: politikanë dhe gazetarë etj., titujt e gazetave dhe shprehjet e reklamave. Janë bërë edhe analiza të diskursit të politikanëve të Republikës së Kosovës, si: Hashim Thaçi, Shpend Ahmeti, Ramush Haradinaj, Vesel Kadriu, Albin Kurti. Përmes postimeve të tyre në rrjetin social *Twitter* brenda periudhave kohore prej 1 deri në 2 vite. Mirëpo, kemi konstatuar se mesazhet e shkurtra të tyre, zakonisht, janë në gjuhën angleze ose të shprehura me një variant të kujdesshëm, me ç'rast përdoret vetëm varianti standard i gjuhës shqipe. Si rezultat, nuk kemi hasur në ndonjë përdorim të veçantë të turqizimave nga ana e politikanëve në rrjetin social të *Twitter*-it, gjë që nuk mund të thuhet për politikanët e Shqipërisë, siç janë: Rama e Basha etj.

Në tabelën e mëposhtme janë ilustruar disa nga shembujt e përdorimit të turqizimave në regjistrat e lartpërmendur:

Tabela 11: Ilustrimi i përdorimit të turqizimave në tekste të shkurta:

Tekste të reklama-ve dhe tituj të artikujve, parullat	Tekste të postuara në twitter	Shprehjet e personave publike& titujt e gazetave
Birrë mas birre shtohet <i>sefaja</i> (Birra-Prishtinë)	Mirë Kadriu i Bahrifalliut më paska çuar në spital me tërë kadrinjtë e portaleve, po ju o miq që merakoseni s'i keni hequr akoma <i>kazanët</i> nga ajfomat?! (Rama)	Basha: Kush nuk distancohet Nga afera e teatrit, është bërë <i>pis</i> (Gazeta Shqiptare)
Birra Prishtina sponzor zyrtare e <i>qejfit</i>	Merren me prita rrugësh në shekullin e XXI e pastaj duan vota nga ky popull Oh <i>ç'derexhe!</i> Meta: Rama ndoshta e ka ditë tersi, por s' duhet të thellohet kriza (Twitter)	Drejtësia e kapur nga Rama, <i>hajdut</i> e mashtrues (Basha, G.SH.)

Shaffer Kosovë - “Kafja ka <i>lezet</i> nëse me servisin prej gjashtë gotave”	Cfarë trishtimi pasqyra e shëmtisë së djeshme nëpër <i>mediat e dynjasë!</i> <i>Politika qorre</i> e një opozite pa vizion, pa program, pa lidership, nuk i bëri asgjë dot qeverisë po goditi Shqipërinë në sytë e botës dhe u dha material të tërë atyre që <i>duan sebepe</i> kundër negociatave me BE (Rama, Twitter)	nuk mbyllet me <i>pazar</i> mes PS-PD (Basha, G.Sh.)
Titulli i programit - KTV: “Kafë me <i>lezet</i> ”	Flm për mesazhet e solidaritetit, po s'më shqetëson <i>hiç boja</i> se me <i>bojrat</i> jam rritur e mësuar Më shqetëson mendja e <i>shpirti katran</i> i palopërfaqësuesve të një populli që s'i meriton këta <i>zorropë</i> . Prandaj jo që s'i hap rrugë <i>budallallëkut</i> , po veç më rritet pasioni e vendosmëria (Rama, twitter)	s'jeni <i>hajna</i> . Izoloheni Edi Ramën. (Basha, G.SH.)
Prej kur t'lind dielli, e deri natën vonë... Kur t'kqyret film n'krevet... Kur t'del <i>n'mahallë</i> me shoqni... Farat ma t'qarta gjithë me veti i ki. Peyman, fara ma e qart' prej krejtve ! – (peyman)	Po ndryshe nga ata, ai i ul vartësit të mbushin <i>çarçafë</i> me dokrra "ligjore" dhe <i>budallallëkut</i> i del zot gjithnjë shkresërisht	Zoti u shtoftë <i>inatit</i> , që të na shtojnë <i>takatin</i> (Rama, G.SH.)
Prej atëherë <i>hala</i> nuk jemi nal - Peyman Planet tuaja për pushime verore bëhen edhe më të <i>lezetshme</i> me Peyman	Erdhi dita që Zëri i Amerikes të flasë nga <i>kazani</i> i Tiranës, duke përgojuar <i>dynjanë</i> mbi bazë llogjesh telefonike Për herë të parë në Albania organizohet konkurs publik për punësimet në burgje dhe <i>kazani</i> gjëmon deri në Amerikë e jehon në katundin tonë mediatik (Rama, twitter)	Me Metën më ka <i>mbetur hatri</i> (Kryemadhi, G.Sh.)

<p>Ky është <i>iftari</i> yt! - KFC</p>	<p>Kadrinjtë më qenkan turrur me radhë, ham e hum, <i>tamam</i> siç janë, lehaqenie <i>pa din, pa iman, pa nishan</i>. Ylli Kadriu e bën për të shpëtuar <i>vatanin</i>, shan e shpif bashkë me vëlla Andin që të rrëzojë <i>Shejtanin!</i> U kthye nga rruga, e la dhe ruletën, leh fort parimori se s'harron dot kuletë</p>	<p>Fieri po vij, <i>kam habere të mira</i> (Gazeta Shqiptare)</p>
<p>Si baba djali - Jaa.. krejt ka dajtë paska ga. Bonja tag <i>dajës</i> ta qet një Big King (KIng Burger)</p>	<p>S'jam marrë kurrë me këtë <i>qenef</i> digjital, po në çdo vend demokratik (+në ligjin shqiptar) çdo përhapës i shpifjes dënohet njësoj si shpifësi!</p>	<p><i>Pes pare s'i jepi</i> (Veseli, Youtube)</p>
<p>Kodiaq i ri për <i>merakli!</i> - reklama e kredisë /Raiffeisen Leasing Kosovë</p>	<p>Më mirë djepi <i>bosh</i> (gjykata e sipërme) se <i>shejtani</i> brenda!</p>	<p>Sonte, vishemi mire e rregullohemi...me makeup mbulojme <i>qehren</i> qe tregon deshprimin, pasigurine, tuten... (Arbana Xharra, FB)</p>
<p>Mos humb vakt tu lyp bankomat - Paguaj me kartelë dhe tërhiq para kesh nga <i>dyqanet</i> (Procredit Bank)</p>		<p>Me kane vec listat e veteraneve me mashtrues, po a ka kush qe i pastron <i>hajnat</i> ne qeveri, neper komuna, ne ndermarrje publike, <i>dallavergjite</i> ne shoqeri civile, pozite e opozite... (Xharra, FB)</p>
<p>Mind the gap! - Plotësoni boshllëkun (Curaprox- revista stomatologjike)</p>		<p>Rama: <i>dajak</i> PD-së dhe DRU deputetit</p>

Përfundim

Personat publikë kanë prirje për të përdorur huazime në përgjithësi, madje edhe turqizmat. Politikanët shqiptarë i përdorin në stile të orientuara nga funksionet shprehëse dhe nxitëse: ironike, metaforike dhe hiperbolike, prandaj më shumë hasen gjatë polemikave. Përdorimi i turqizmave në këto regjistra tregon në fakt se folësi apo autori i caktuar dëshiron të përdorë një ligjërim popullist dhe këtë karakteristikë të turqizmave e përdor për qëllim të afërimit me popullin. Retorika populiste i transformon faktet e çështjeve shoqërore në metafora dhe simbole. Jo të gjithë politikanët e funksionalizojnë këtë pjesë të leksikut të gjuhës shipe. Ka edhe të tillë që e parapëlqejnë stilin formal në çdo rast, sidomos gjatë përçarjes së mesazhit në regjistra në formë të shkruar. Kjo tregon se turqizmat përdoren në ligjërimin joformal.

Nga ana tjetër, te tekstet e muzikës shqiptare, po ashtu, shihet një përdorim më të shpeshtë të stilit joformal. Një rritje e përdorimit të turqizmave shihet në kodet e nivelit të ulët të ligjërimin (argo etj.). Sidomos në zhanrin e muzikës rap dhe hip-hop, e cila dëgjohet nga masa e gjerë e popullit shqiptar. Sa më i ashpër, i drejtpërdrejtë, ironik dhe satirik të jetë diskursi i tekstit të këngës, aq më shumë turqizma përfshin. (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12). Prania e turqizmave shfaqet për dy arsye: 1. Për shkak të ruajtjes së formës, ritmit dhe rimës (14), (16), (17); 2. Për shkak të qëllimit të komunikimit dhe kontekstit (13); Për shkak të temës së trajtuar. Nga krahasimi i këngëve të vjetra popullore me këngët e reja, kuptojmë se turqizmat e këngëve popullore bashkëkohore ende përdoren si “shkresësit” gjuhësore për evokimin e një statusi shoqëror të veçantë.

Analiza e teksteve të reklamave tregon përsëri një funksionalizim i këtij leksiku në stilin evokues me qëllim për të arritur te populli, duke krijuar një ambient oriental, më “popullor”, ndoshta nostalgjik apo melankolik. Po ashtu, turqizmat shihen edhe si mjete gjuhësore të përdorura në stilet vlerësuese dhe bindëse.

Literaturë:

- Ismajli, R. (2019), Bashkësi gjuhësore, njësitë, varietet, ASHAK: Prishtinë
- Desnickaja, A. V. (2006). Mbi funksionin stilistik të turqizimeve në poezinë shqipe, Perla Revistë Shkencore–Kulturore tremujore, Viti XI, Nr. 4 (43), fq.126-134
- Dizdari, (2005), Fjalori i Orientalizmave të Gjuhës Shqipe, Tiranë: AIITC
- Douglas, B. & Finegan, E. (1994), Sociolinguistic Perspective on Register, New York & Oxford: Oxford University Press
- Douglas B, & Conrad S. (2019), Register, Genre and Style, Cambridge University Press
- Grup Autorësh, (1981), Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Prishtinë: Rilindja (Qasja e fundit: 01 maj 2020)
- Kostallari A., (1978), Rreth depërtimit të turqizimeve në gjuhën shqipegjatë shekujve XVII-XVIII, Gjurmime Albanologjike, SSHF, Prishtinë
- Krajni A., (1965), Hymja e turqizimeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre, Studime Filologjike, 1, f.143-151
- Kazazis, Kostas (1969), The status of turkisms in the present-day balkan languages, Continuity and Change, International Balkan Conference, october , (H. Birnbaum and S. Vryonis (eds.)”
- Lloshi, Xh., (1999), Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, Tiranë: Albas
- Leech, Geoffrey N., and Michael H. Short. 1981. Style in fiction. London: Longman.
- Mulaku, Latif (1989), Turqizmat në gjuhën shqipe, SKSH 3, Prishtinë,
- Reinkowski, M. (2002), Kulturerbe oder Erblast? Zum Status der Turzismen in den Staaten Südosteuropas, insbesondere des


Bosnischen“, në: Mediterranean language review 14. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag

- Rugova, B ve Rugova, L.S. (2015), Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe, Prishtinë: Trembelat
- Rugova, L. (2017), The formal and informal status of Turkish loanwords in Albanian. Trakya Üniversitesi Edebiyat Fakültesi Dergisi VII(13), Ocak 2017, s.225-234
- Steen, Gerard, (2002), in: “Cognitive Stylistics: Language and cognition in text analysis”, ed. E. Semino & J.Culpeper, “Metaphor in Bob Dylan’s “Hurricane”187-192”, JB B.V.:Amsterdam.
- Thomai et al. (2006), Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë: ASHSH (Qasja e fundit: 01 maj 2020)

<http://www.fjalori.shkenca.org>

<https://fjalorthi.com>

Grafikoni 1.



*Zeqije Xhafçe*²

THE USE OF TURKIZM IN REGISTERS OF LOW-LEVEL FORMALITY

Summary

Our research addresses deals with an important part of the Albanian lexicon which has been the subject of older studies in this area. This research aims to highlight the turkisms which are used at a low level of formality. The analysis of the use of this part of the Albanian vocabulary is based on the theory of corpus linguistics, the theory of languages it has contact with and on the sociolinguistic approach to language registers. The study relies on the linguistic multifunctionality and pluralism, on the basis of which the functionalization of turkisms has been explored. The study was conducted in search of answers to the following questions: Have the turkisms moved from the high level of formality registers to the low level? In order to find the answer to this question, the turkisms of the 3 corpuses of spoken and written Albanian registers were treated.

Key words: *Turkism, Albania Lexicon, Corpus linguistics.*

² Lecturer in Turkish Language, Department of Oriental Studies at University of Prishtina, Prishtina.